

Bazuar në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 75 dhe VKA nr. 5, datë 14. 08. 2020 “Për shtesa e ndryshime në Rregulloren nr. 3/2, datë 26.02.2008 “Për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” dhe sipas Urdhrit Nr. 7739 Prot., datë 03.09.2024 të Drejtorit Rajonal të Sigurimeve Shoqërore Fier “Për hapjen e procedurës së rekrutimit të personelit nëpërmjet konkurimit të hapur”, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Fier, bën shpalljen e vendeve të lira të punës për pozicionet:

DRSSH Fier / ALSSH Lushnje

- Inspektor Bujku (Njësia Administrative Ballagat), **1(një) vend**

DRSSH Fier / ALSSH Fier

- Inspektor Bujku (Njësia Administrative Levan), **1 (një) vend**

Kandidatët konkurues :

- Duhet të zotërojnë diplomë Universitare të Nivelit të Parë/Bachelor, të barazvlefshëm me të, sipas legjislacionit të Arsimit të Lartë.

Kërkesat e përgjithshme specifike

- Të jenë shtetas shqiptarë;
- Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jenë në kushte shëndetësore që lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tyre të mos jenë marrë masa disiplinore të largimit nga sistemi i sigurimeve shoqërore, shërbimi civil ose administrata publike, që nuk janë shënuar, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet testimi me shkrim & intervista

- Njohuri në fushën e Sigurimeve Shoqërore (Statuti i ISSH, Ligji Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”).
- Njohuri të Rregulloreve Financiare, të Përfitimeve, të Kontributeve dhe për sistemin e informacionit të ISSH;
- Njohuri të Ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat";
- Njohuri të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë;
- Njohuri të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
- Njohuri të Ligjit Nr .9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në ushtrimin e Funkcioneve Publike”;
- Njohuri të Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Në vlerësimin e kandidatëve përfshihen :

- vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve: që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën;
- vlerësimi me shkrim: që konsiston në vlerësimin e njohurive për legjislacionin e zbatueshëm për sigurimet shoqërore, organizimin administrativ në sistemin e sigurimeve shoqërore, për nivelin e njohurive akademike dhe profesionale, bazuar në kriteret e përcaktuara;
- intervista me gojë ku zhvillohet intervistimi i kandidatëve, i cili synon të evidentojë formimin e përgjithshëm, si dhe vizionin e tyre mbi veprimtarinë e sigurimeve shoqërore dhe për pozicionin që konkuron.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- për vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve, **deri në 20 pikë**;
- për intervistën me gojë, **deri në 40 pikë**;
- për vlerësimin me shkrim, **deri në 40 pikë**.
- Kandidatët konkuroes kualifikohen nëse në total ka fituar **mbi 70 pikë**, nga 100 pikë të mundëshme, gjatë fazës së vlerësimit

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat në zyrën e protokollit të DRSSH Fier, si më poshtë:

- Një kërkesë për konkurim për pozicionin e punës për të cilin është i interesuar.
- Një kopje e jetëshkrimit (CV);
- Fotokopje e diplomës dhe listës së notave (e noterizuar);
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Raport të aftësisë për punë
- Fotokopje e librezës së punës;
- Certifikatë ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme;
- Fotokopje e Kartës së Identitetit

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave duhet të bëhet brenda datës 10.09.2024, pranë zyrës së protokoll / sekretarisë në DRSSH Fier.

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më lartë.

Testimi me shkrim do të zhvillohet në ambjentet e DRSSH Fier, në datën **11.09.2024**, ora **10:00**.

Intervista me gojë do të zhvillohet në ambjentet e DRSSH Fier, në datën **12.09.2024**, ora **10:00**.

